


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. Regj. Them.4012 (3138)

Dt.01.06.2015

VENDIM
“Për sigurimin e padisë”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë e përbërë prej:

Gentian Medja – Gjyqtar

asistuar nga sekretare seance Orgesa Mucaj, sot më 01/06/2015, mori në shqyrtim në séanceë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative me nr.regj.them.4012 (3138), dt.13.05.2015, qe i përket:

KERKUES: Shoqëria Neproma Service SRL, përfaqësuar nga Av. Genci Cifligu.

TE PADITUR: 1. Komisioni Prokurimit Publik, përfaqësuar nga EriLinda Lala dhe Avokatja e Shtetit Katerina Behaj.
2. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, përfaqësuar nga Megi Celiku dhe Arlinda Pogaj dhe Avokatja e Shtetit Katerina Behaj.

PALE E TRETË: 1. Shoqëria “A.G.S” shpk, me adresë Rr. “Beqir Luga”, pallati nr.3, Shkalla 1/1, Tiranë, përfaqësuar nga Av. Elton Lula.
2. Bashkimi i Operatorëve ekonomike “Devis” shpk dhe “Dimënsione të reja” shpk & “Univers servis” shpk dhe A-K company Shpk, me adresë Rr. “Sami Frashëri”, pallati nr.22/1, Tiranë(në mungesë).
3. Shoqëria “KPL” shpk, me adresë Rr. “Alqi Mëdhi”, Pallati i ri, Shkalla 5, Zyra 1, Tiranë(në mungesë).
4. Bashkimi i operatorëve ekonomike “Shpresa” shpk & “Servizi shtetëror Integriti” srl me adresë Bulevardi Gjergj Fishta, Shkalla nr.2, Tiranë, përfaqësuar nga Av. Eltiona Metani.
5. Shoqëria W-Center Shpk, me adresë Rr. “8 Shkurti”, pallati përballë Gjymnazit “Perikli Ikonomi”, Fier(në mungesë).
6. Bashkimi i operatorëve ekonomike “Ballkan Laundry 14” shpk & “Serv Hotel” s.r.l, me adresë autostrada Durrës – Tiranë, Km 7, Durrës(në mungesë).

OBJEKTI: Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar pezullimin e zbatimit të vendimit Nr.199, datë 16.03.2015 të Komisionit të Prokurimit Publik (KKP), deri në zgjidhjen e çështjes nga gjykata.



BAZA LIGJORE: Nenet 7 e vijues: 15; 17; 29 të Ligjit Nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Nenet 32/a, 324 – 331 të KPC; nenet 47, 51, 56/1/e, 93, 118, 145 të KPA; Ligji nr.9643/2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; Vendimi nr.1, date 10.01.2007 i Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit Publik", i ndryshuar.

Në përfundim të gjyimit, gjykata pasi dëgjoi përfaqësuesen e palës paditëse, Shoqërisë Neproma Service Srl, Av.Genci Çifliku, i cili kërkoj pranimin e kërkesës, dëgjoi përfaqësuesen e Komisionit të Prokurimit Publik, Erilinda Lala, e cila kërkoj rrëzimin e kërkesës(e cila nuk ishte e pranishme në shpalljen e vendimit), dëgjoi përfaqësuesen e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Megi Celiku, e cila kërkoj rrëzimin e kërkesës(e cila nuk ishte e pranishme në shpalljen e vendimit), përfaqësuesen e Avokaturës së Shtetit, Katerina Behaj, e cila kërkoj rrëzimin e kërkesës(e cila nuk ishte e pranishme në shpalljen e vendimit), përfaqësuesin e Shoqërisë "A.G.S" shpk, Av. Elton Lula, i cili e la në çmim të gjykatës kërkesën për sigurim padie(i cili nuk ishte i pranishëm në shpalljen e vendimit), përfaqësuesen e Bashkimit të operatorëve ekonomike "Shpresa" shpk & "Servizi Sanitari Integrati" s.r.l, Av. Eltona Metani, e cila e la në çmim të gjykatës kërkesën për sigurim padie(e cila nuk ishte e pranishme në shpalljen e vendimit), zhvilloi gjykimin në mungesë të Bashkimit të Operatorëve ekonomike "Devis" shpk dhe "Dimensione të reja" shpk & "Univers servis" shpk dhe A-K company Shpk, Shoqërisë "KPL" shpk, Shoqërisë W-Center Shpk, Bashkimit të operatorëve ekonomike "Ballkan Laundry 14" shpk & "Serv Hotel" s.r.l dhe shqyrtoi në tërësi çështjen

VËREN se

Shoqëria Neproma Service SRL i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë padie kundër Komisionit të Prokurimit Publik dhe Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, me objekt: 1.Shfuqizimin e pjesës së aktit administrativ, Vendimit Nr.199/2015, datë 15.04.2015 të Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KKP), dhe konkretisht: Pika 2(dy) e dispozitivit, vetëm pjesa që ka të bëjë me anulimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave(në vijim KVO) për kualifikimin e operatorit ekonomik "Neproma Service 11" srl; 2.Shfuqizimin e plotë të pikës 3(tre) dhe 4(katër) të dispozitivit të këtij vendimi, detyrimin e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë të vazhdojë procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur, mbi kufirin monetar" me objekt "Për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë në pavionet e QSUT Nënë Tereza" Tiranë, duke shpallur fitues Shoqërinë Neproma Service srl dhe të lidhë kontratën.

Së bashku me kërkesë padinë, pala e paditur ka kërkuar dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezulton e provuar se: Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë ka shpallur procedurën e prokurimit publik për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e QSUT-së. Pala kërkuese ka hyrë në këtë procedurë konkurrese dhe ka bërë ofertën e saj.

Më 16.02.2015, KVO-ja ka shpallur kualifikimet e ofertave në sistemin elektronik. Në këtë njohim ka rezultuar se janë kualifikuar katër operatorë, ndër të cilët dhe pala kërkuese. Ajo është kualifikuar e para, së bashku me Bashkimin e Operatorëve

ekonomike "Devis" shpk, "Dimensione të reja" shpk & "Univers servis" shpk dhe A-K company Shpk.

Operatorët ekonomik AGS Shpk, Bashkimi i Operatorëve ekonomike "Devis" shpk dhe "Dimensione të reja" shpk & "Univers servis" shpk dhe A-K company Shpk, Bashkimi i operatorëve ekonomike "Shpresa" shpk & "Servizi Sanitari Integrati" s.r.l kanë paraqitur ankim pranë Autoritetit Kontraktor.

Pasi Autoritetit Kontraktor u ka kthyer përgjigje, operatorët AGS Shpk, dhe bashkimi i Operatorëve ekonomike "Devis" shpk dhe "Dimensione të reja" shpk & "Univers servis" shpk dhe A-K company Shpk i janë drejtuar KPP-së.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr.199/2015, datë 15.04.2015, KPP-ja ka vendosur që: 1.Të pranojë ankesat e paraqitura nga operatorët AGS Shpk, dhe bashkimi i Operatorëve ekonomike "Devis" shpk dhe "Dimensione të reja" shpk & "Univers servis" shpk dhe A-K company Shpk; 2.Autoriteti kontraktor të anullojë vendimet e KVO-s për kualifikimin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë "Devis" shpk dhe "Dimensione të reja" shpk & "Univers servis" shpk dhe A-K company Shpk, operatorit ekonomik Neproma Service Srl, operatorit ekonomik AGS Shpk dhe Bashkimit të operatorëve ekonomik "Shpresa" shpk & "Servizi Sanitari Integrati" s.r.l. KPP-ja ka vendosur që të anullojë procedurën e mësipërme të konkurimit sepse nuk ka mbetur më ndonjë ofertë e vlefshme pas anulimit të vendimeve të KVO-së.

Në këto kushte, pala paditëse Shoqëria Neproma Service Srl i është drejtuar Gjykatës me padinë e mësipërme dhe me kërkesën për sigurimin e padisë.

Ajo pretendon se asaj i shkaktohet një dëm i rëndë dhe i pakthyeshëm. Ekzekutimi i vendimit të KPP-së do t'i hiqte asaj mundësinë për t'u shpallur fituese në një procedurë ku ajo është kualifikuara e para.

Palët e paditura KPP-ja, QSUT-ja dhe Avokatura e Shtetit pretenduan se nuk provohet që nga ekzekutimi i vendimit të KPP-së palës kërkuese i shkaktohet ndonjë dëm i rëndë dhe i pakthyeshëm. Ato pretenduan se ndërprerja e procedurës i shkakton një dëm të rëndë interesit publik.

Personat e tretë, Shoqëria AGS Shpk dhe Bashkimi i operatorëve ekonomike "Shpresa" shpk & "Servizi Sanitari Integrati" s.r.l. kërkesën në lidhje me sigurimin e padisë e lanë në çmim të gjykatës.

Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi çështjen arriti në konkluzionin se kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar.

Konform nenit 29 të ligjit nr.49/2012 rezulton se: *"Gjykata vendos sigurimin e padisë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresë, për mundësinë e shkakut të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin; b) nuk cenohet rëndë interesi publik.*

Në rastin konkret gjykata vlerëson se plotësohen kushtet e përcaktuara nga dispozita e sipërcituar. Rezulton e provuar se pala kërkuese ka hyrë në procedurën konkurruese, duke investuar në kohë dhe në mjete monetare në përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së saj. Në këtë procedurë ajo është renditur e para dhe kjo procedurë është anuluar. Duke u shfuqizuar ky vendim (për vlerësimin si fituese) tek kjo gjykatë u krijua dyshimi i arsyeshëm se ndaj palës paditëse ekziston mundësia e shkakut të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm. Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit të KPP-së, i heq asaj mundësinë e lidhjes së kontratës me Autoritetin kontraktor dhe i pakëson çdo mundësi që oferta e saj në një procedurë të dytë të jetë fituese.

Kjo gjykatë çmon se me pezullimin e efekteve të vendimit të KPP-së, nuk i shkaktohet ndonjë dëm interesit publik, përkundrazi. Nga shqyrtimi i kërkesës rezultoi se

para e paktuar QSO 1-ja ka zhvilluar një procedurë të përshtetshme për blerje e shërbimit të kërkuar. Në mënyrë që të plotësojë nevojat imediate për këtë lloj shërbimi, siç është ai i lavanderisë dhe hotelerisë në pavionet e saja, shërbim i cili në vetvete ka natyrë imediate. Rifillimi i procedurës për blerjen këtij shërbimi mund të sjellë cenim të interesit publik. Në këto kushte, kjo gjykatë vlerëson se interesi publik, nuk ndodhet para një cenimi të rendë, i cili nuk mund të tolerojë kohën e nevojshme për gjykimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 28 e 29 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI

- Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë.
- pezullimin e efekteve të vendimit nr.199/2015 të Komisionit të Prokurimit Publik.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë, brenda 5 ditëve nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, Për Komisionin e Prokurimit Publik, Qendrën Spitalore Universitare "Nene Tereza", Tiranë, Avokaturën e Shtetit, Shoqërinë "A.G.S" shpk, Bashkimin e operatorëve ekonomikë "Shpresa" shpk & "Servizi Sanitari Integrati" s.r.l., Bashkimin e Operatorëve ekonomikë "Devis" shpk dhe "Dimensione të reja" shpk & "Univers servis" shpk dhe A-K company Shpk, Shoqërinë "KPI" shpk, Shoqërisë W-Center Shpk dhe Bashkimin e operatorëve ekonomikë "Ballkan Laundry 14" shpk & "Serv Hotel" s.r.l. ky afat fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

U shpall sot më 01/06/2015.

Sekretare
Orgesa Mucaj



Gjyqtar
Gentian Medja

